

Auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit marrin pjesë në programin e trajnimit në Gjykatën Europiane të Audituesve (ECA)

Për më shumë se një dekadë, bashkëpunimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Europiane të Audituesve nëpërmjet praktikave të trajnimit ka kontribuar në formimin profesional të audituesve të KLSH-së për të aplikuar standardet dhe praktikat më të mira europiane në fushën e auditimit.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi u zhvillua programi i trajnimit në Gjykatën Europiane të Audituesve në Luksemburg për periudhën 1 Tetor 2024 deri në 28 Shkurt 2025, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj. Blerta Hima, përgjegjëse Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë; z. Fatlum Dogjani, auditues në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja; z. Erald Kojku, auditues në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja; znj. Mirela Vasil, audituese në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore; z. Blerti Shehu, auditues në Departamentin e Auditimit të Institucioneve të Sigurisë dhe Pronës Publike ku janë angazhuar në Dhomat (Chambers) respektive të ECA-s:



Blerta Hima

Chamber I: Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore



Fatlum Dogjani

Chamber II: Investim për kohezion, rritje dhe përfshirje



Erald Kojku

Chamber III: Veprimi i jashtëm, siguria dhe drejtësia



Mirela Vasil

Chamber IV: Rregullimi i tregjeve dhe ekonomia konkurruese



Blerti Shehu

Chamber V: Financimi dhe administrimi i unionit

Praktika profesionale kishte për qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të audituesve dhe t'u ofronte atyre njohuri mbi praktikat më të mira dhe metodologjitë e përdorura nga ECA. Objektivat kryesore përfshinin fitimin e një kuptimi gjithëpërfshirës të proceseve të auditimit të ECA-s, vëzhgimin e qasjes së ECA-s për të siguruar transparencën financiare dhe përgjegjshmërinë brenda Bashkimit Evropian, nxitjen e marrëdhënieve profesionale dhe zbatimin e njohurive të fituara për të përmirësuar praktikën e auditimit në KLSH. Audituesit morën pjesë në takimet e planifikimit dhe ekzekutimit të auditimit për të kuptuar strategjitë e ECA-s, si dhe në trajnime për aspekte të ndryshme të auditimit si vlerësimi i rrezikut dhe kampionimi i auditimit. Gjithashtu u angazhuan në grupe auditimi dhe bashkëpunuan në detyra specifike auditimi për të fituar përvojë praktike, si dhe në sesione të shkëmbimit të njohurive me ekspertët e ECA-s për tema si auditimi i performancës, financiar dhe i përputhshmërisë, aplikimi i inteligjencës artificiale në auditim etj.

Përfitimet kryesore nga trajnimi në Gjykatën Europiane të Audituesve përfshijnë njohuri të metodologjive bashkëkohore të ECA-s, përmirësim të teknikave të vlerësimit të riskut, rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies dhe rëndësinë e një metodologjie të organizuar dhe të strukturuar në procesin e auditimit. Kjo eksperiencë nxit rritjen e zhvillimit profesional të pjesëmarrësve dhe kontribuon në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e auditimit.



Njohuritë dhe aftësitë e fituara synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e praktikave të auditimit të KLSH-së, për të mësuar nga praktikat më të mira dhe për të investuar vazhdimisht në përmirësimin e kapaciteteve të institucionit për të ruajtur transparencën dhe llogaridhënien.